
ENVIRONMENTAL EDUCATION FOR WASTE ADMINISTRATION IN PRIMARY SCHOOL IN KOSOVA EDUKIMI MJEDISOR PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE NË ARSIMIN FILLOR NË KOSOVË

FLORIJE TAHIRI^{a*}, ARDIAN MAÇI^b,

^a. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Rruga "Luan Haradinaj", Prishtinë, Republika e Kosovës

^b. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Republika e Shqipërisë
loravk@hotmail.com

AKTET V, 3: 398 - 402, 2012

PERMBLEDHJE

Në vendin tonë institucionet e edukimit mjedisor janë në ndërtim e sipër, kurrikulumet dhe njësitë mësimore për mjedisin janë në nivel të pamjaftueshëm. Mbrojtja e mjedisit konsiderohet si çështje dytësore. Nga sasitë e mëdha të mbeturinave të shpërndara kudo, shihet qartë se është e domosdoshme të punohet në ngritjen e edukimit mjedisor. Hulumtimi në institucionet shkollore është bërë me qëllim të një pasqyrë të njohurive të nxënësve për administrimin e mbeturinave. Për hulumtim janë marrë nxënësit e klasëve I-V, të shkollës fillore 7Marsi, në Prishtinë dhe Bedri Gjina, në Mitrovicë. Anketa ka përfshirë pyetje rreth njohurive të tyre për administrimin e mbeturinave. Rezultatet e anketës janë përpunuar me metoden statistikore deskriptive, me softverin SPSS. Nga hulumtimi vërehet se nxënësit për administrimin e mbeturinave njohuritë e përgjithëshme i kanë në shkallë të ultë dhe është mëse e nevojshme të shtohet fondi i orëve dhe lëndë e veçantë për edukimin mjedisor.

Fjalë kyçe: edukim mjedisor, kurrikulum, hulumtim, anketë, administrim.

SUMMARY

In our country, environmental education institutions are under construction, curriculum and learning units to the environment are in inadequate level. Environmental protection considered as a secondary issue. From large quantities of waste scattered everywhere, it is clear that it is necessary to work in environmental education increase. The research in institutional school is done intently an overview of pupils knowledge of waste management. For research are taking pupils classes I-V, the primary school 7Marsi, in Prishtina and Bedri Gjina, in Mitrovica. The questionnaire has included questions about their knowledge for the waste management. The results of research are processed by the descriptive statistical methods with SPSS software. Survey noted that the pupils knowledge of waste management in general have a low level and is necessary to added the fund hours and special subject for the environmental education.

Key words: environmental education, curriculum, investigation, questionnaire, administration.

HYRJE

Në vendin tonë institucionet e edukimit mjedisor janë në ndërtim e sipër, prandaj dhe kurrikulumet mësimore me përmbajtje mjedisore janë në nivel të pamjaftueshëm. Në tekstet shkollore vetëm në mënyrë simbolike shkruhet për administrimin e mbeturinave (1, 2, 3, 4, 5, 6,

7, 8, 9, 10). Informimi mediatic i publikut për mjedisin është shumë i mangët. Përkrahja për OJQ-të mjedisore nga institucionet publike është e vogël (8).

Problemet ekologjike të grumbulluara me dekada (11) dhe administrimi jo i drejtë i mbeturinave, mos shfrytëzimi i lëndëve sekondare (12), vendin

tonë e rendit në kuadër të vendeve me zhvillim të vogël (13).

Në Republikën e Kosovës jetojnë rreth 1.733.872 banorë, dhe vetëm 42% e tyre përfitojnë shërbime nga kompanitë publike të mbeturinave (14), ndërsa për shërbimet e ofruara nga kompanitë private nuk dihet gjë. Përveç disa raporteve të publikuara për gjendjen e mbeturinave nga MMPH, ZRRUM dhe Enti i statistikave, nuk ka ndonjë publikim për administrimin e mbeturinave (15).

Duke pasur parasysh sasinë e madhe të mbeturianve të shpërndara kudo (7, 9), shihet qartë se në vendin tonë është e domosdoshme të punohet në ngritjen e vetëdijësisimit për dobiet e administrimit të drejtë të mbeturinave (10).

1. METODOLOGJIA E PUNËS

Për hulumtimin e edukimit mjedisor në arsimin fillor është analizuar kurrikulumi arsimor dhe librat e arsimit fillor në nivel kombëtar (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10).


Hulumtimi është realizuar në dy qytete të Kosovës, në Mitrovicë dhe Prishtinë. Mitrovica si qendër mesatare ose e përafërt me qendrat e tjera të Kosovës dhe Prishtina si kryeqytet me numrin më të madh të nxënësve. Studimi është bërë në Sh.F. B.Gjina, në Mitrovicë dhe 7 Marsi, në Prishtinë. Janë bërë fotografi të lumenjëve afër shkollave, ku shihen mbeturina në lumë. Gjatë hulumtimit është bërë anketë me nxënës të arsimit fillor të klasës së I-II-III-IV dhe V-të, të moshës 6-13 vjeç (16). Janë hartuar pyetësorët për nxënësit: për klasën e parë pyetësori ka pasur 10 pyetje, ndërsa për klasat tjera 21 pyetje. Anketa është bërë gjatë orëve mësimore. Nxënësve pyetësorët (bonbone si stimulim) ua kanë shpërndarë mesueset e klasave përkatëse. Anketa me nxënësit ka zgjatuar një orë mësimore. Hulumtimi është bërë me metodë të njëjtë në Mitrovicë dhe Prishtinë.

2. REZULTATET DHE DISKUTIMET


2.1. Kurrikulumi për edukimin mjedisor në Kosovë dhe vende të tjera

Në arsimin fillor në Kosovë, kurrikula për të nxënësit e nxënësve për fushën e mjedisit është e

organizuar në lëndët natyrore dhe shoqërore (17, 18) kurse në Irlandë është e organizuar përmes lëndës së edukimit mjedisor, në Finlandë dhe Greqi përmes lëndës studime mjedisore, në Gjermani përmes studimeve të përgjithshme dhe në Slloveni përmes shkencave natyrore dhe sociale (18). Vërehet se shumica e vendeve të tjera kanë përcaktuar lëndë të veçantë edukimin mjedisor në mënyrë që nxënia e nxënësve të jetë më e frytshme.



Diag.1. Lënda ku është mësuar për mbeturina



Diag.2. Ku krijohen mbeturinat


2.2. Analiza e pyetësorëve

Të dhënat nga anketa janë mbledhur, janë përpunuar me metoda statistikore deskriptive, me softverin SPSS, ku përgjigjet nga pyetësorët janë futur në bazën e të dhënave, dhe për secilën pyetje është gjetur përqindja dhe janë formuar edhe grafikone.

Në Sh.F.B.Gjina nga 328 nxënës, janë anketuar 120 nxënës, prej tyre 52 femra dhe 68 meshkuj dhe në Sh. F. "7 Marsi", nga 299 nxënës, janë anketuar 136 nxënës prej tyre 70 femra dhe 66 meshkuj.

Sh. F. “B. Gjina” në Mitrovicë

Në pyetjen “A duhet të futet lëndë e veçantë në shkollë për mjedisin”, prej 120 nxënësve, 75.8 % shprehen pozitivisht ku 81 % e tyre mësimet i konsiderojnë si ligjërata për mbeturina, 75.8 % prej tyre e dinë çka janë mbeturinat. Për pyetjen “A bisedojnë me prindërit” 85 % thonë po. Në pyetjen “A e ndotin mbeturinat mjedisin”: 82.5 % thonë po, 13.3 % thonë jo, 3.3 % nuk e dinë dhe 0.8% e kanë konceptin e ngatërruar; “Ku krijohen mbeturinat”: 32.5 % në shport, 18.3 % shtëpi, shkolla, 45 % kontejner dhe 4.2 % tjetër; “Çka duhet të bëjmë me mbeturinat”: 5 % ti hedhim në lumë, 90 % në kontejner, 2.5 % në rrugë dhe 2.5 % tjetër; “Ku shkojnë mbeturinat”: 10% në lumë, 54.2% në riciklim, 20.8% në deponi, 0.8% nuk din, 0.8 % në fabrikë, 13.3 % klasa e parë nuk është përfshirë (tash e tutje mungon); “A mund të ndahen mbeturinat”: 72.5 % po, 14.2 % jo 13.3 % nuk përgjigjen; “Si mund t’i ndajmë mbeturinat”: 32.5 % në pjesë, 54.2 % në letër, plastikë etj., 13.3 % mungon; “Çka bëni me mbeturinat e shtëpisë”: 7.5 % hedhim në lumë, 85 % në kontejner, 4.2 % në natyrë, 3.3 % diku tjetër; “banorët e lagjes ku i dërgojnë mbeturinat”: 15 % në lumë, 42.5 % në kontejner, 3.3 % në natyrë, 1.7% diku tjetër, 24.2 % deponi, 13.3 % mungon; “Sa shpesh merren mbeturinat”: 40.8 % në javë, 12.5 % më shpesh, 15.8 % nuk merren fare, 16.7 % nuk din, 0.8 % të ngatërruar, 13.3 % mungon.



Diag.3. Ku shkojnë mbeturinat

Në pyetjen “A ndahen mbeturinat në shkollën e tyre”: 47.5 % shprehen pozitivisht, prej tyre 29.2 %, thonë mbeturinat që ndahen shkojnë në riciklim, kurse 70 % thonë në kontejner dhe 0.8 % mungon.

Rezultatet në pyetjen “çka është riciklimi”: 16.7 % ndarje, 42.5 % përpunim, 12.5 % klasifikim, 15 % nuk din, 13.3 % mungon; “A njihni ndonjë kompani që mbledh mbeturina për riciklim”: 18.3 % po, 27.5 % jo, 5.8 % deponi, 35 % nuk din, 13.3 % mungon; “Pse duhet të riciklohet”: 40 % për përpunim, 29.2 % ruajtje të mjedisit, 15.8 % nuk din, 1.7 % të ngatërruar, 13.3 % mungon; “Shenja e riciklimit”: 27.5 % e din, 59.2 % nuk din, 13.3 % mungon; “A keni marrë pjesë në aktivitete për ndarje dhe riciklim të mbeturinave”: 26.7 % po, 60 % jo, 13.3 % mungon; “A do të merrni pjesë në aktivitete për ndarje dhe riciklim të mbeturinave”: 78.3 % po, 21.7 % jo.

Sh. F. “7 Marsi” në Prishtinë


Në pyetjen “A duhet të futet lëndë e veçantë në shkollë për mjedisin”, prej 136 nxënësve, 90.5 % shprehen pozitivisht ku 84.6 % e tyre mësimet i konsiderojnë si ligjërata për mbeturina, 63.2 % prej tyre e dinë çka janë mbeturinat. Për pyetjen “A bisedojnë me prindërit” 83.8 % thonë po.

Në pyetjen “A ndotin mbeturinat mjedisin”: 82.4 % thonë po, 11 % thonë jo, 6.6 % nuk e dinë; “Ku krijohen mbeturinat”: 10.3 % në shport, 52.2 % shtëpi, shkolla, 11 % kontejner dhe 26.5 % tjetër; “Çka duhet të bëjmë me mbeturinat”: 1.5 % ti hedhim në lumë, 94.9 % në kontejner, 2.9 % në rrugë dhe 0.7 % tjetër; “Ku shkojnë mbeturinat”: 2.2 % në lumë, 11.2 % në riciklim, 56.6 % në deponi, 7.4 % nuk din, 7.4 % në fabrikë, 14.7 % mungon; “A mund të ndahen mbeturinat”: 74.3 % po, 11 % jo, 14.7 % mungon; “Si mund t’i ndajmë mbeturinat”: 31.6 % në pjesë, 53.7 % në letër, plastikë etj., 14.7% mungon; “Çka bëni me mbeturinat e shtëpisë”: 3.7 % hedhim në lumë, 91.2 % në kontejner, 1.5 % në natyrë, 3.7 % diku tjetër; “Banorët e lagjes ku i dërgojnë mbeturinat”: 4.4 % në lumë, 65.4 % në kontejner, 2.9 % në natyrë, 4.4 % diku tjetër, 8.1 % deponi, 14.7 % mungon; “Sa shpesh merren mbeturinat”: 47.1 % në javë, 14 % më shpesh, 2.2 % nuk merren fare, 21.3 % nuk din, 0.7 % të ngatërruar, 14.7 % mungon.


Në pyetjen “A ndahen mbeturinat në shkollën e tyre” 32.4 % shprehen pozitivisht, prej tyre 5.9 % thonë mbeturinat që ndahen shkojnë në riciklim

derisa 91.9 % thonë në kontejner, 0.7 % e kanë konceptin e ngatërruar dhe 1.5 % thonë se mbeturinat shkojnë në lumë.

Rezultatet në pyetjen “Çka është riciklimi”: 21.3 % ndarje, 22.1 % përpunim, 8.1 % klasifikim, 33.8 % nuk din, 14.7 % mungon; “A njihni ndonjë kompani që mbledh mbeturina për riciklim”: 7.8 % po, 29.3 % jo, 37.1 % deponi, 25.9 % nuk din, 14.7% mungon; “Pse duhet të riciklohet”: 9.6 % për përpunim, 24.3 % ruajtje të mjedisit, 51.5 % nuk din, 14.7 % mungon; “Shenja e riciklimit”: 22.1 % e din, 63.2 % nuk din, 14.7 % mungon; “A keni marrë pjesë në aktivitete për ndarje dhe riciklim të mbeturinave”: 20.6 % po, 64.7 % jo, 14.7 % mungon; “A do të merrni pjesë në aktivitete për ndarje dhe riciklim të mbeturinave”: 68.4 % po, 31.6 % jo.



Diag.4.Pse duhet të riciklohet



Diag.5.Shenja e riciklimit

2.3. Krahasimi i rezultateve mes dy shkollave

Në bazë të hulumtimeve të mia nuk kam hasur në ndonjë studim të kësaj natyre në vendet tjera përveq përshkrimin të kurrikulumeve për edukimin mjedisor(10). Në mungesë të kësaj unë jam marrë vetëm me krahasimin e rezultateve të

dy shkollave ku unë kam bërë hulumtimin. Bazuar në rezultatet nga anketa, për njohuritë e nxënësve për administrimin e mbeturinave, për të dy shkollat për nxënësit e klasëve prej I-V, janë bërë krahasime, në disa pyetje që është menduar se janë me interes. Në anketim për klasën e parë nuk kanë qenë të përfshira disa pyetje, ku kemi shenuar se mungojnë përgjigjet.

Në pyetjen “A ndotin mbeturinat mjedisin”, të dy shkollat janë përgjigjur përafërsisht ngajshëm se mbeturinat janë ndotës; në pyetjen “Çka bëjmë me mbeturinat”: 5 % hedhen në lumë të Sh.F. B.Gjina krahasuar me 1.5 % hedhen në lumë të Sh.F. 7Marsi dhe 2.5 % në rrugë të Sh.F. B.Gjina krahasuar me 2.9 % në rrugë të Sh.F.7Marsi, ku jep të kuptohet se në Mitrovicë ndotet lumi më shumë dhe në Prishtinë rruga; “Banorët e lagjes ku i dërgojnë mbeturinat”, përgjigjja është një pjesë në lumë dhe natyrë ku dominon Sh.F. B.Gjina; “A ndahen mbeturinat në shkollë”, që të dy shkollat thonë po, por kur shtrohet pyetja se ku shkojnë pas ndarjes, mbi 70 % e tyre thonë se shkojnë në kontejner; “Çka është riciklimi”, 39.7 % që nuk e din janë nga Sh.F.7Marsi krahasuar me 17.3 % Sh.F. B.Gjina; “A njihni ndonjë kompani ricikluese”, me mosnjohje paraprin Sh.F. B.Gjina, por kur pyetet cila kompani mendohet në deponi me 37.1 % Sh.F.7Marsi krahasuar me 6.7 % Sh.F. B.Gjina. Në aktivitete për grumbullimin e mbeturinave, vërehet se nga të dy shkollat një numër i vogël kanë marrë pjesë por në përgjithësi që të dy palët janë të gatshëm në të ardhmen të marrin pjesë nëse ato organizohen.

“Lënda ku është mësuar për mbeturina”, Sh.F. B.Gjina favorizon Edukatën qytetare dhe Njeriu dhe natyra derisa Sh.F.7Marsi favorizon Njeriu dhe natyra krahas Punë dore, derisa shumë ulet është Ekologjia (diagrami 1). “Ku krijohen mbeturinat”, vërehet dallim mes të dy shkollave (diagrami 2) ku Sh.F. B.Gjina favorizon shtëpitë dhe shkollat (52.2 %) si krijuesit më të mëdhenjë të mbeturinave derisa Sh.F.7Marsi favorizon kontejnerët (45%). “Ku shkojnë mbeturinat”, (diagrami 3) Sh.F. B.Gjina me (11.5 %) thonë në lumë, (62.5 %) riciklim krahas Sh.F.7Marsi (2.6 %) në lumë dhe (66.4 %) në deponi. Në pyetjen “Pse

duhet të riciklohet” (diagrami 4), Sh.F. B.Gjina jep përgjigje që lenë të kuptohet se e din çka është riciklimi dhe dobietë prej tij derisa në Sh.F.7Marsi rreth 60 % nuk din. “Shenjën e riciklimit” (diagrami 5), më tepër e kanë të njohur Sh.F. B.Gjina.

Dallimet e shumta në përgjigje dhe konfuzioni që paraqitet te nxënësit në njohuritë e tyre për administrimin e mbeturinave, na detyron të mendojmë për të gjetur mënyrën që nxënësve tu japim më shumë njohuri.

3. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Edhe pse në përgjithësi nxënësit kanë njohuri elementare, shihet se e kanë të ngatërruar kuptimin e ndarjes, riciklimit dhe deponimit të mbeturinave. Në shkolla nuk zhvillohen aktivitete për edukimin mjedisor, njësitë mësimore për mjedisin janë të pakta, sipërfaqësore dhe të shpërndara nëpër shumë lëndë. Nxënësit nuk e kanë kuptuar rëndësinë e një mjedisi të pastër pa mbeturina(duke i hedhur kudo), dhe administrimin e drejtë të mbeturinave si pasuri sepse resurset minerale natyrore duhet ruajtur. Mësimdhënëset e ciklit klasor edhe vetë nuk janë mjaft të informuar me problemet e mjedisit. Objektet dhe hapësirat në shkolla janë të pastra, por menjëherë jashtë tyre ka mbeturina, ku edhe nxënësit shihen duke hedhur ambalazhe prej sendeve që i konsumojnë. Bashkëpunimi në mes institucioneve me interes për mjedisin mungon, ka shumë për t’u bërë në këtë drejtim dhe duhet një angazhim serioz i strukturave arsimore ku MASHT të angazhohet në plotësimin e kurrikulimit, ku mbrojtja e mjedisit dhe administrimi i mbeturinave të kenë hapësirë të konsiderueshme, MASHT të inkorporoj në shkolla lëndë të veçantë për edukimin mjedisor, mësimdhënësit të kontribuojnë në vetëdijësimin e nxënësve për mjedisin duke zhvilluar aktiviteteve për riciklim dhe krijimin e grupeve ekologjike në shkolla.

BIBLIOGRAFIA

1. Bejtullahu R., Bicaj M., Rrustemi R. 2008, Njeriu dhe Natyra 5, fletore pune fq. 10.
2. Bejtullahu R., Bicaj M., Rrustemi R. 2011, Njeriu dhe Natyra 4, fq. 90-91.
3. Bejtullahu R., Bicaj M., Rrustemi R. 2011, Njeriu dhe Natyra3, fq.6,26.
4. Dida K., Reka Y., Cukaj B. 2011, Punedore 2, fq. 23,27.
5. Gashi A., Halili F., Bajraktari I., Ajazaj H. 2007, Njeriu dhe Natyra 5, fq.74.
6. Mato E., Shatri B. 2011, Edukata Qytetare 3, fq. 79.
7. Mato E., Shatri B. 2011, Edukata Qytetare 4, fq. 21-22.
8. Mato E., Shatri B. 2011, Edukata Qytetare 5, fq.33(fletore pune).
9. Mustafa B. 2007, Ekologjia dhe Mjedisit 5-6, fq.13-15,17,19, 39-40,51,57, 60-62.
10. Shatri B., Mato E., 2011, Edukata Qytetare 5, fq.6,15,21-22,81.
11. Hyseni M., Matthies P. 2011 Qershor, Anash approaching science, analet e Alb-Shkencës Viti VI, Nr.8, fq.15-18.
12. Tahiri F.2007, Mbeturinat shtëpiake në komunën e Mitrovicës dhe efektet e riciklimit të tyre, fq.31,76.
13. Tahiri F. 2008, aktet Vëll.II nr.3, fq.81,82.
14. ZRRUM 2009 Raport fq.3.
15. MAP, 2009 Anketa e mbeturinave komunale Seria 2,Statistikat e Buqësisë dhe Mjedisit.
16. ESK, 2010, Statistikat e arsimit 2009 / 2010 fq.7,9,11,15.
17. Boshtrakaj L. korrik 2010, Korniza e kurrikulimit të Kosovës doracak i zhvilluesve të Kurrikulimit
18. MASH, Maj 2011.Analiza krahasuese e kurrikulës aktuale të arsimit bazë me atë të vendeve të tjera, fq:7,10-16,19.